



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 6152/prot.  
3

Tiranë, më 02.12.2022

U R D H Ë R

Nr. 643 , Datë 02.12.2022

“PËR  
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË ISH-  
NOTERES RUDINA HAJREDINI”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

**KONSTATOJ:**

Me Urdhrin nr. 7502/2, datë 30.11.2016, të Ministrit të Drejtësisë është vendosur heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit znj. Rudina Hajredini. Nga verifikimi, lidhur me arkivën noteriale të ish noterës nuk rezulton që nga ana e komisionit përcaktuar në pikën 2 të urdhit nr. 7502/2, datë 30.11.2016, të Ministrit të Drejtësisë, të jetë realizuar marrja e kësaj arkive nga ana e komisionit.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të ish noterës Rudina Hajredini, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e ish noterës, si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së thatë dhe të njomë të ish-noterës.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të shkresës nr. 5733/2 prot., datë 22.11.2022 të Degës Vendore të Noterisë Shkodër,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të ish noterës Rudina Hajredini, i përbërë nga antarët e mëposhtëm:
  - a.) Z. Endit Kalaja, specialist, Sektori Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë;

- b.) Znj. Matilda Hoxha, specialiste, Sektori Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- c.) Znj. Diana Toro, specialiste, Sektori Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- d.) Znj. Rudina Podgorica, përfaqësuese nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër;
- e.) Z. Arben Kopliku, përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

2. Ish-noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.

3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë antarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.

4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterës së Degës Vendore të Noterisë Shkodër **znj. Admira Boriçi**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteri plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noterës **znj. Admira Boriçi**, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish noterës Rudina Hajredini.

7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personit përgjegjës si dhe ish noterës Rudina Hajredini.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
ULSI MANJA

